



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.1.2025

Nr: 36

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
KAMËZ, PËR PERIUdhËN 17 JANAR – 18 JANAR 2025**

Sot, më datë 24.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Kamëz

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Kamëz për periudhën 17 janar deri më 18 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 17-18 janar 2025, Bashkia Kamëz ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Informim/ ndërgjegjësim, “*Informim i publikut nëpërmjet një videoje ilustruese lidhur me funksionimin e sistemit të ri të taksave dhe shërbimet që do mund të marrin qytetarët nëpërmjet tij*”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 21.1.2025,

Data: 24.1.2025 Nr: 36
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Kamëz, për periudhën 17 janar – 18 janar 2025”

- Inspektim, “Inspektim në Shkollën “Azem Hajdari” në Babrru, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 21.1.2025.

Nëpërmjet email-it të datës 22.1.2025, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Kamëz informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 24.1.2025, ora 13:00.

Pas njoftimit të kryer, Bashkia Kamëz ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: “Për shkak të ndryshimit të agjendës së Kryetarit të Bashkisë, konkretisht aktiviteti “Inspektim në Shkollën “Azem Hajdari” në Babrru”, është shtyrë në datën 23.1.2025, në orën 12:00 dhe aktiviteti “Informim i publikut nëpërmjet një videoje ilustruese lidhur me funksionimin e sistemit të ri të taksave dhe shërbimet që do mund të marrin qytetarët nëpërmjet tij”, është shtyrë në datën 23.1.2025, në orën 14:00. Për sa më lart, ju vëmë në dijeni se këto dy aktivitete janë raportuar sërish në datat dhe orën e sipërcituar”.

Nga verifikimet e kryera në ndërfaqën e raportimeve rezulton se këto dy aktivitete janë raportuar sërish brenda afatit ligjor.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaritë publike e zhvilluar nga Bashkia Kamëz, nuk përbëjnë shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Pasi veprimtaritë kanë marrë shënimin si të ndaluara, Bashkia Kamëz nuk i ka zhvilluar këto aktivitete por i ka riraportuar ato me datën e zhvillimit duke respektuar afatet ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Kamëz.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI